



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:916314
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05514923

C.nr. 775/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtaren Mirjeta Shala dhe zyrtarin ligjor Drilon Zymeraj, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses K.,Sh.a (K.), Bulevardi "...", nr.3 – Ndërtesa e ... Kati II, nr.5 – Prishtinë – D.. në Gjakovë, të cilën e përfaqëson i autorizuari T.G., me autorizim në shkresat e lëndës, kundër të paditurit B.C., nga Komuna e Gjakovës, për kompensim të dëmit material, vlera e kontestit 2,498.49 €, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe të paditurit, me datë 18 mars 2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses K, Sh.a (K.) – Prishtinë - Distrikti në Gjakovë.

II. DETYROHET i padituri B,C., nga Komuna e Gjakovës, që paditëses të lartpërmendur në emër të kompensimit të dëmit material t'ia paguaj shumën prej 2,498.49 € (dymijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë euro e katërdhjetë e nëntë cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë 24.11.2017 deri në pagimin definitiv, si dhe shpenzimet procedurale në lartësi prej 790.00 €, e gjitha këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcenim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja me datën 24.11.2019 në këtë gjykatë ka parashtruar padi, kundër të paditurit B.C., për shkak të kompensimit të dëmit material në vlerë prej 2,468.49 €. Në padi ka theksuar se i padituri, me datë 20.11.2015, me qëllim që vete të i sjellë pasuri të kundërligjshme, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që jashtë njehsorit elektrik, përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik, duke bërë kështu që energjia elektrike e shpenzuar të mos regjistrohet saktë. Ka shtuar se i njëjti, sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr. 814/16, të datës 12.05.2017, i cili aktgjykim ka marrë formën e prerë, i padituri ka pranuar

fajësinë dhe është shpallur fajtor për veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale, përderisa e dëmtuara, këtu paditësja, është udhëzuar në kontest civile për kompensimin e dëmit të shkaktuar.

Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktgjykimin C.nr. 677/2017, të datës 28.02.2019, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses K., (K...) – Prishtinë - Distrikti në Gjakovë. Ndaj këtij aktgjykimi, brenda fatit ligjor, paditësja përmes të autorizuarit të saj ka parashtruar ankesë me datë 05.04.2019. Gjykata e shkallës së dytë, me aktvendimin Ac.nr. 2358/19, të datës 12.05.2021, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditëses K., (K.– Prishtinë - Distrikti në Gjakovë, duke ia kthyer Gjykatës në rivendosje këtë çështje juridike kontestimore.

Në seancën e shqyrtimit kryesor pas kthimit të lëndës në rishqyrtim dhe rivendosje dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditëses ka deklaruar se mbetin pranë padisë dhe kërkesëpadisë, si dhe të gjitha deklaramete nga seancat e kaluara. Ka shtuar se meqë nga superekspertiza e grupit të ekspertëve të Fakulteti Teknik rezulton se vlera e dëmit të shkaktimit nga i padituri është 2,498.49 Euro, sipas përlogaritjes nga grupi i ekspertëve, atëherë bëjmë edhe precizimin e kërkesëpadisë, sa i përket vlerës së dëmit në shumën prej 2,498.49 Euro. Ka shtuar se pas shqyrtimit dhe administrimit të të gjitha provave, është konstatuar dhe vërtetuar se i padituri, paditëses i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 2,498.49 Euro, i cili dëm është shkaktuar nga vepra penale Vjedhje e shërbimeve Komunale nga neni 320 të KPRK-së, i cili është dënuar me aktgjykimin penal P.nr. 814/2016. Lartësia e dëmit të shkaktuar nga i padituri, u vërtetua në bazë të ekspertizës të punuar nga grupi i ekspertëve, të cilës kërkoj nga Gjykata që t'ia falë besimin, andaj i propozojmë Gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, ta aprovoj si të bazuar, të obligoj të paditurin në shpenzimet e procedurës për taksës gjyqësore, në vlerë prej 40.00 Euro, si dhe në shpenzimet për përpilimin e superekspektizës nga grupi i ekspertëve, në vlerë prej 750.00 Euro.

I padituri në seancën e shqyrtimit kryesor pas kthimit të lëndës në rishqyrtim dhe rivendosje dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë qëndrimeve që i kam pasur deri më sot, pra të gjitha atyre çka kam deklaruar nga seancat e kaluara, për çka shtoj se kam argumente se nuk e pranoj dëmin që është bërë, duke u nisur nga faturat para se të jetë ndërruar ora dhe pasi që është ndërruar ora, pra shpenzimet janë të njëjta, ashtu që unë nuk e kam keqpërdorur orën. Ashtu siç e përmenda, unë bazohem në faturat të cilat janë në shkresat e lëndës, unë nuk e di që pas ndërrimit të orës, vjen e njëjta gjendje dhe nuk mund të dijë se si mund të thuhet se është keqpërdorur ora, por edhe tash, kur është shtrenjtuar rryma, fatura maksimale më vjen në lartësi prej 40.00 Euro, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e bëra deri më tani.

Ndryshimin e padisë në aspektin objektiv, përkatësisht zmadhimin e kërkesëpadisë, Gjykata e ka lejuar me aktvendimin e datës 18.03.2024, në kuptim të nenit 258 paragrafi 4 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, për faktin se një ndryshim i tillë në këtë fazë të procedurës ka qenë pa fajin e paditëses dhe atë pas të gjeturave nga ekspertiza e punuar nga grupi i ekspertëve.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor-publik, administroi këto prova: Ekspertiza e ekspertit të elektroteknikës M.D., , e datës 03.10.2018, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, me numër P.nr. 814/16, i datës

12.05.2017, i plotfuqishëm me datë 14.06.2017, Raporti i Kalkulimit me numër 28209, i datës 09.12.2015, Fatura me numër DGj15H505522, i datës 09.12.2015, Leximi në rrjedhën e historiatit të energjisë aktive, në lokalit të paditurit B.C, me numër 9003657, i datës 08.05.2017.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palës paditëse dhe provave të nxjerra, në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

- Gjendja faktike e vërtetuar

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, me numër P.nr. 814/16, i datës 12.05.2017, i plotfuqishëm me datë 14.06.2017, vërtetohet se i padituri i lartpërmendur është shpallur fajtor, për veprën penale: vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 i KPRK-së dhe gjykata në rastin konkret në kuptim të nenit 4, 17, 41, 46, 49, 50, 51, 73 dhe neni 320 të KPRK-së, si dhe neni 365, të KPPK-së, e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (tre) muajve, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 200.00 €, të cilat dënime nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa të dëmtuarën, këtu paditësen e ka udhëzuar që të drejtën e saj për kompensim të dëmit, të e realizojë në kontest civil.

Leximi i raportit të kalkulimit me numër 28209 i datës 09.12.2015 gjykatës i provojë rrethanën se bazuar në përlllogaritjen e paditëses, e njëjta ka bërë përlllogaritjen e humbjeve të konsumatorit, këtu të paditurit në kohëzgjatje prej 12 muaj në lartësi prej 1,879.00 euro.

Nga Fatura me numër DGj15H505522, e datës 09.12.2015, me përshkrim rikthim i humbjeve, u vërtetuar se nga përlllogaritja e paditëses lidhur me sasinë e shpenzimeve të humbjeve për shkak të veprës penale është në lartësi prej 2,498.49 €.

Nga Ekspertiza e ekspertit të elektroteknikës M.D., e datës 03.10.2018, konstatohet se eksperti ka ardhur në kolaudime se nga krahasimi i faturimit të energjisë elektrike për periudhën 01.01.2011 e deri me 31.12.2017, shihet se energjia e faturimit për punëtorin e pronarit B.C., në periudhën kohore të lartëcituar, nuk ka diferencë të madhe të harxhimit të energjisë elektrike, përkatësisht mesatarja vjetorë e energjisë se faturuar nga data 01.01.2011 e deri me datë 31.12.2017, është 3146.3 KWh, ndërsa faturimi për rikthim të humbjeve për një vit (12) muaj është 26772 KWh. Ka shtuar se një ndryshim kaq i madh i energjisë së faturuar, sipas mendimit të ekspertit, është bërë si rezultat i përfshirjes së fuqisë së njëkohshme të makinave elektrike të evidentuara në procesverbalin e komisionit inspektues të KEDS-it. Në bazë të lartëcekurave, ka ardhur në përfundim se në bazë të krahasimit të energjisë së shpenzuar në punëtorinë e pronarit B.C., në intervalin kohor pra dhe pas ndërrimit të njehsorit elektrik, shihet se nuk ka ndryshime të theksuara të konsumit të energjisë elektrike, ora konsumi i energjisë elektrike edhe pas ndërrimit të njehsorit për matjen e energjisë elektrike të shpenzuar, nuk ka ndryshuar, andaj

rrjedhimisht, nuk ka mundur që të konstatoj se ka pasur shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, në punëtorinë e B.C., , këtu të paditurit.

Në drejtim të vërtetimi të lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata bazuar në rekomandimet e gjykatës së shkallë së dytë, sipas propozimit të autorizuarës së paditëses, ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e elektros, e që përpilimi i të njëjtës i është besuar Fakultetit Teknik – Dega e Elektros.

Nga ekspertiza e punuar nga grupi i ekspertëve nga Fakulteti i Teknikës – Dega e Elektros, të dorëzuar pranë kësaj Gjykate me datë 24.07.2023, dhe atë në përbërje prej Prof.Ass. V.R., – Kryetar i komision, MSc. F.M., – anëtar, si dhe Msc. N.SH., – anëtar, është konstatuar se ky komision, bazuar në dokumentacionin e ofruar të shkresave të lëndës, ka bërë kalkulimin e shpenzimit të energjisë elektrike, megjithatë komisioni ka vërejtur se në shkresat e lëndës mungon procesverbali origjinal i K..-it, andaj ka marrë parasysh tabelën me shpenzues të pajisjeve të energjisë elektrike të kalkuluar nga Departamenti për Konsumatore – Sektori i Rikthimit të Humbjeve, me pajisjet elektrike të cilat dyshohet se kanë qenë të kyçura në ditën kritike, me ç`rast ky komision, bazuar në fuqinë e pasijeve elektrike dhe kohën e punës së tyre, bazuar në rregulloren e K..-it për konsumator jo familjar, aprovuar nga ZRRE-ja, ka ardhur në konstatim se për 22 ditë punë, me nga 8 orë në ditë, është shpenzuar 2231 kWh energji elektrike. Ndërsa, kanë llogaritur edhe energjinë mesatare mujore të faturuar për këtu të paditurin në cilësi të konsumatorit, e që është $E_H = 352 \text{ kWh}$, me ç`rast pas kalkulimeve të bëra, kanë ardhur në konstatim se rikthimi i humbjeve duhet të jetë $E_{\text{faturim}} = E_H - E_{\text{mes}}$, mujore = $2231 \text{ kWh} - 352 \text{ kWh} = 1879 \text{ kWh}$ (energja për faturim për 22 ditë pune për muaj), e cila në përlllogaritje në euro, kap shifrën prej 2,498.49 Euro.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18.03.2024, është dëgjuar eksperti i elektroteknikës, nga grupi i ekspertëve që kanë punuar ekspertizën, përkatësisht Prof. Ass.Dr. V.R., , i cili ka deklaruar se qëndroj pranë ekspertizës së përpiluar në grupin e përbërë nga unë dhe dy (2) ekspertë të tjerë. Në si grup i ekspertëve kemi pasur për detyrë kalkulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike, për periudhën e kontestuar. Në atë kalkulime kemi llogaritur sipas procedurave që janë të bazuara edhe në kuadër të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike, pra se si llogariten shpenzimet e energjisë elektrike. Pastaj, janë llogaritur motorët që kanë qenë, sipas kohëzgjatjes një (1) vjeçare, periudha dimërore, verore dhe çmimi i atij viti, sipas tarifave çmimore të atij viti.

- Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Me neni 137 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës nr. 16, me datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, parashihet që “*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)*”, ndërsa me nenin 154 par. 1 të parashihet që “*Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë t’u kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Në anën tjetër me neni 14 të Ligjit Nr.06/L-006 për Procedurën Kontestimore parashihet

që “Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.

Gjykata nga administrimi i provave, vlerësimit dhe analizimit të tyre, pretendimet e paditësit se i padituri i ka shkaktuar dëm paditëses i gjen të bazuara. Nisur nga fakti se i padituri me P.nr. 814/16, i datës 12.05.2017, i plotfuqishëm me datë 14.06.2017, është shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 i KPRK-se, rrjedh se për gjykatën është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadsisë së paditëses, pasi që në rastin konkret gjykata lidhet me aktgjykimin penal i cili është i formës së prerë ku është vërtetuar përgjegjësia penale e të paditurit.

Ndërsa sa i përket lartësisë së kërkesëpadsisë, gjykata vendosi duke marrë për bazë ekspertizën nga lëmia e elektroteknikës, e punuar nga grupi i ekspertëve të Fakultetit Teknik, në përbërje prej Prof.Ass.Dr. V.R., – Kryetar i komision, MSc. F.M., – anëtar, si dhe Msc. N.SH., – anëtar, sipas të cilës është konstatuar se i padituri me shfrytëzimin e energjisë elektrike në mënyrë të pa autorizuar i ka shkaktuar dëm palës paditëse në vlerën prej 2,498.49€. Gjykata ekspertizës së punuar nga grupi i ekspertëve, ia fali besimin pasi që e njëjta është përpiluar në mënyrë shkencore dhe profesionale, duke i plotësuar si të tilla kushtet ligjore.

Ndërsa nuk ia fali besimin ekspertizës së ekspertit të elektroteknikës M.D., e datës 03.10.2018, i cili ka theksuar se nuk ka mundur që të konstatoj se ka pasur shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, në punëtorinë e B.C., , këtu të paditurit, për faktin se sa i përket vërtetimit të bazës juridike, e njëjta është vërtetuar me aktgjykimin penal me të cilin i padituri është shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 i KPRK-se. Gjykatave ne dukje se sa i perkat fajësisë gjykata bazuar në neni 14 të LPK-së është e lidhur me aktgjykimin penal, ashti siç edhe është vepruar në këtë rast. Në anën tjetër, i padituri në asnjë mënyrë nuk ka argumentuar se dëmi i lartëcituar i paditëses, është shkaktuar pa fajin e tij.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata erdhi në përfundim se i padituri me veprimet e tij paditëses i ka shkaktuar dëm në lartësi prej 2,498.49€, fakte këto që u vërtetuan nga provat e administruara dhe të elaborara si më lartë. Andaj si rezultat i kësaj gjendje faktike të vërtetuar e në zbatim të dispozitave ligjore nga neni 137 dhe 154 i LMD-së, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8 %, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur prej e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u morr sipas nenit 450.1 të LPK-së që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale iu pranua shuma prej 790.00 €, e cila lartësi i referohet taksës gjyqësore të paguar për padi e paraparë me Udhëzimin për Unifikim e Takave Gjyqësore si dhe për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga grupi i eksperteve shumën prej 750.00 euro.

Nga të lart cituarat, e në kuptim të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.775/21, datë 18 mars 2024

Gj y q t a r j a,
Mirjeta Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.